



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 482 Akti

Nr. 599 Vendimi
Tiranë, më 16.12.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Genta Tafa (Bungo)	Relatore
Valbona Sanxhaktari	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 15.12.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Sokol Pasho**, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Z. Sokol Pasho, aktualisht me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, është subjekt i rivlerësimit, që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) në datën 15.6.2020 zhvilloi procedurën e shpërndarjes me short të çështjeve në trupa gjyqësore, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit Sokol Pasho do t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjyqësor i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Lulzim Hamitaj dhe Valbona Sanxhaktari. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Genta Tafa (Bungo).

4. Në mbledhjen e datës 17.6.2020 u caktua me mirëkuptim kryesuesi i trupit gjyqësor, z. Lulzim Hamitaj, si dhe u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga dy anëtarët e trupit gjyqësor. Relatorja e zgjedhur me short deklaroi mundësinë e gjendjes së konfliktit të interesit. Trupi gjyqësor i zgjedhur me short me vendimin nr. 42, datë 30.6.2020, të Komisionit, vendosi mospranim e kërkesës për dorëheqje me vendimin nr. 2, datë 2.7.2020. Në këto kushte, relatorja e çështjes administroi dokumentacionin dhe filloi hetimin administrativ me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit.

5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Sokol Pasho nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ). Këto raporte janë administruar nga relatorja me fillimin e hetimit administrativ.

10. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Sokol Pasho. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

11. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka dërguar raportin² e saj për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Sokol Pasho.

12. KLGJ-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim, nga relatorja e çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 1.12.2022, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

15. Subjekti i rivlerësimit, në datën 1.12.2022, u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i

¹ Shkresë nr. *** prot., datë 17.9.2018.

² Raport nr. *** prot., datë 6.5.2022, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 25.8.2022, të KDZH-së.

³ Shkresë nr. *** prot., datë 29.9.2021.

rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 02.02.2022, ndërsa më 12.12.2022 ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në përgjigje të rezultateve të hetimit.

16. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore⁴.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *email* në datën 12.12.2022.

18. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 15.12.2022, ora 14:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma.

19. Subjekti i rivlerësimit Sokol Pasho mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Z. Sokol Pasho ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë të gjithë procedurës së hetimit administrativ.

20.1. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

21. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21.1. Referuar vendimit nr. 2/2017⁵ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë

⁴ Vendimi nr. 3, datë 12.12.2022.

⁵ “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe

kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet e administruar nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë Komisionit nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

23. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si edhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

23.1. Subjekti ka filluar detyrën në datën 7.3.2016 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

23.2. Në deklaratën *Vetting* (shtojca 2) të dorëzuar në ILDKPKI në datën 23.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

24. Apartament⁶ me sipërfaqe 111.6 m², me nr. pasurie nr. *, krijuar në vitin 2001, regjistruar në vitin 2008, me vlerë 36,000 USD, me vendndodhje në Rrugën e Dibrës, Tiranë. Pjesa takuese: 50%.**

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: për pjesën e tij takuese në masën 50%, subjekti ka deklaruar si burim të ardhura nga puna, si dhe 1,000,000 lekë të ardhura nga shitja e apartamentit me kontratën nr. ***, datë 21.5.1997. Bashkëshortja e subjektit për pjesën e saj takuese në masën 50% ka deklaruar si burim të ardhurat nga puna, si dhe 3,000,000 DRH (tre milionë dhrahmi) nga puna e prindërve.

Hetimi⁷/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.2.2008; certifikatë pronësie nr. ***, datë 30.3.2008 për pasurinë apartament nr. ***; kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.5.1997.

⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 16.10.2020 nga ASHK Tiranë Jug; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 9.12.2020 nga ASHK Tiranë Veri; shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar FSHU-ja; shkresë kthim përgjigjeje nr. ***

25. Me kontratë sipërmarrjeje⁸ nr. ***, datë 17.6.1999, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë porositur nga shoqëria “K **” sh.p.k. apartamentin 2+1, me sip. 101 m², me vlerë 370 USD/m². Sipas përcaktimeve të kësaj kontrate, pagesa e vlerës së apartamentit do të bëhej me këste, ku kësti i parë në masën 50% të vlerës totale do të likuidohej në momentin e prenotimit dhe të lidhjes së kontratës, kësti i dytë në masën 40% të vlerës totale do të likuidohej në momentin e kryerjes së punimeve të rifiniturës dhe kësti i tretë prej 10% në momentin e marrjes në dorëzim dhe hyrjes së porositësit në apartament.

26. Me kontratë shitjeje nr. ***, datë 20.2.2008, subjekti dhe bashkëshortja kanë blerë nga shoqëria “K **” sh.p.k. apartamentin e mësipërm me nr. pasurie ***, z. k. ***, ndodhur në Rrugën e Dibrës, Tiranë. Në përmbajtje të kontratës shitësi deklaroi se këtë pasuri ia shet blerësve për çmimin 36,000 USD, shumë e cila është likuiduar nga blerësit jashtë zyrës noteriale.

27. I pyetur lidhur me momentin e kryerjes së pagesave në favor të shoqërisë “K” sh.p.k., në përgjigje të pyetësorit datë 12.7.2022, subjekti ka deklaruar: *“Pagesa për blerjen e apartamentit në Rrugën e Dibrës është kryer me disa këste në vitet 1999, 2000 dhe kësti i fundit në vitin 2001”*. Ai i ka bashkëlidhur përgjigjes së tij disa nga mandatpagesat e kryera në favor të shoqërisë ndërtuese, me përmbajtje si vijon:

- mandatarkëtimi datë 17.6.1999 për pagesën e vlerës 10,000 USD;
- mandatarkëtimi datë 6.2.2000 për pagesën e vlerës 4,000 USD;
- mandatarkëtimi datë 16.6.2000 për pagesën e vlerës 1,800 USD;
- mandatarkëtimi datë 16.6.2000 për pagesën e vlerës 244 USD.

28. Referuar deklaramëve periodike të subjektit pranë ILDKPKI-së, nga viti 2003 e në vijim ka deklaruar si adresë banimi: *“Rruga e Dibrës nr. ***, Tiranë”*. Gjithashtu, në përgjigje të pyetësorit standard subjekti ka deklaruar: *“Deri në vitin 1997 kam banuar në apartamentin në rrugën ‘K.C’, p. **, shk. **, ap. **, ku kam qenë bashkëpronar. Nga viti 1997 deri në vitin 2001 kam banuar në apartamentin në rrugën ‘F.Xh’, p. **, shk. *, ap. **, në pronësi të motrës S.P. Nga viti 2001 e në vijim banoj në të njëjtin apartament në Rr e D, p. **⁹, shk. *, ap. **, në bashkëpronësi me bashkëshorten M.P”*.

Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie

29. Subjekti, në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar si burim: (i) të ardhurat nga shitja e apartamentit me kontratën nr. ***, datë 21.5.1997, në vlerën 1,000,000 lekë; (ii) të ardhurat e prindërve të bashkëshortes së tij në vlerën 3,000,000 DRH (tre milionë dhrahmi); dhe (iii) të ardhurat nga puna e tij dhe e bashkëshortes.

30. Në lidhje me shumën 1,000,000 lekë të përfituar nga shitja e apartamentit sipas kontratës nr. *, datë 21.5.1997**

prot., datë 2.10.2020 nga FSHU-ja; shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2019, drejtuar UKT-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. K-*** prot., datë 6.10.2020 nga UKT-ja; shkresë nr. *** prot., datë 30.1.2018, e ZQRPP-së drejtuar ILDKPKI-së.

⁸ Kontrata e sipërmarrjes është paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 1, datë 12.7.2022.

⁹ Nr. i pallatit ka qenë ***.

i. Me kontratë shitjeje datë 30.4.1997, subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij¹⁰ kanë blerë nga NKBanesa apartamentin me sip. 88.6 m², ndodhur në rrugën “K.Ç”, për çmimin 30,950 lekë.

ii. Në vijim, përmes kontratës nr. ***, datë 21.5.1997, subjekti, së bashku me familjarët e tij, kanë shitur këtë pasuri në favor të blerësit P. L. për çmimin 2,000,000 lekë.

iii. Duke konsideruar faktin se kjo pasuri ka qenë e regjistruar në pronësi të 5 bashkëpronarëve, Komisioni ka pyetur subjektin lidhur me arsyen e përfitimit të 50% të vlerës së shitjes së këtij apartamenti. Në përgjigje të pyetësorit datë 12.7.2022 subjekti ka deklaruar se: *“Ky apartament është shitur në vlerën 2,000,000 lekë dhe pjesa e tij takuese ka qenë 400,000 lekë. Shuma prej 400,000 lekësh i është dhuruar nga tezja B.M, e cila ka qenë bashkëpronare me 1/5 pjesë, e pamartuar e pa fëmijë dhe ka jetuar në një banesë me familjen e subjektit dhe se ka ndërruar jetë në vitin 2003. Nga nëna e tij K.P, gjithashtu, bashkëpronare në 1/5 pjesë i është dhuruar shuma prej 200,000 lekësh. Për shkak të marrëdhënies së posaçme (një familje), dhurimi i këtyre shumave nuk është formalizuar me ndonjë dokument, në kohën e dhurimit”.*

iv. Sqarimeve të tij, subjekti i ka bashkëlidhur: (a) deklaratën noteriale nr. ***, datë 25.7.2022, të nënës së tij K.P, përmes së cilës ajo deklaron se në vitin 1997 i ka dhuruar djalin të saj shumën 200,000 lekë, të përfituar nga pjesa si bashkëpronare me 1/5 pjesë në shitjen e apartamentit të ndodhur në rrugën “K.C”, Tiranë; (b) certifikatën e vdekjes të shtetases B.M, sipas së cilës në bazë të regjistrimit akt vdekje Njësia Nr. *, Tiranë, akti nr. ***, datë 13.8.2003, vërteton se e ndjera B.M, me gjendje civile beqare, ka ndërruar jetë në datën 8.8.2003.

31. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e depozituara prej tij në kushtet kur shuma në total prej 600,000 lekësh i është dhuruar nga: (i) tezja e tij, për të cilën provohet që ka qenë beqare dhe ka ndërruar jetë në vitin 2003 duke e bërë të pamundur depozitimin e ndonjë deklarate noteriale për të provuar dhurimin e kësaj shume; dhe (ii) nëna e tij, fakt i cili provohet me deklaratë noteriale të datës 25.7.2022; (iii) duke marrë në konsideratë marrëdhënien e posaçme familjare të dhurimit të kësaj shume, si dhe deklarimin si burim të saj në deklaratën *Vetting*, por edhe në deklaratat periodike – i vlerëson bindëse shpjegimet e subjektit, duke u provuar burimi i shumës 1,000,000 lekë.

32. Në lidhje me vlerën 3,000,000 DRH (tre milionë dhrahmi) me burim të ardhurat nga puna e prindërve të bashkëshortes

32.1. Në lidhje me këtë vlerë, subjekti, së bashku me deklaratën *Vetting*, ka depozituar mandatpagesën nr. **, datë 4.1.1997, sipas së cilës znj. M.K ka kryer tërheqjen e depozitës në vlerën 3,000,000 dhrahmi.

32.2. Përmes pyetësorit datë 12.7.2022 Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë dokumentacionin justifikues lidhur me të ardhurat e ligjshme të prindërve të bashkëshortes së tij, të cilat kanë shërbyer si burim për dhënien e shumës 3,000,000 DRH (tre milionë dhrahmi) në favor të saj. Në përgjigjen e tij, subjekti ka sqaruar: *“Shuma prej 3,000,000 dhrahmi është përfituar nga puna në Greqi në vitet 1991 – 1994 nga babai i bashkëshortes, K.K, dhe më pas është depozituar nga M. K (nëna e bashkëshortes) tek kompania ‘V.H’ në vitin 1996 është e tërhequr në vitin 1997. Për shkak të kohës së largët, në shtetin grek nuk disponohen të dhëna lidhur me pagesat e punës së përfituar prej tij. Kjo shumë i është dhënë bashkëshortes prej*

¹⁰ K.P, nëna e subjektit; B.M, motra e nënës së subjektit; D.P, motra e subjektit; S.P, motra e subjektit.

prindërve përpara martesë dhe për shkak të marrëdhënies së posaçme (një familje) nuk është formalizuar me ndonjë dokument”.

Subjekti i ka bashkëlidhur përgjigjes së tij:

- dokument regjistrimi si shtetas i huaj i z. K.K (babai i bashkëshortes së subjektit) në shtetin grek, në vitin 1992;
- mandatarkëtimi nr. ***, datë 4.7.1996, sipas të cilit znj. M.K ka depozituar pranë shoqërisë “V.H” shumën 3,000,000 dhrahmi;
- mandatpagesë nr. **, datë 4.1.1997, lëshuar nga arka e kreditit të shoqërisë “V.H”, sipas së cilës znj. M.K ka kryer tërheqjen e shumës 3,000,000 dhrahmi.

33. Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 21.9.2022, i ka kërkuar Ministrisë së Financave (shoqëritë huamarrëse në administrim) informacion të detajuar në lidhje me depozitimet e kryera nga ana e prindërve të bashkëshortes së subjektit në firmat piramidale.

Ministria e Financave, me shkresën nr. *** prot., datë 26.9.2022, ka informuar se shtetasja M.K figuron kreditore në shoqërinë piramidale “V.H” sh.p.k., tani në administrim. Nga përpunimi i kartelës rezultoi se ajo ka lidhur kontratë huaje me nr. ***, datë 10.6.1996 dhe përfiton si kreditore me koeficient sipas ligjit për shpërndarjen e vlerave financiare kreditorëve, dhe konkretisht:

33.1. Për kontratën e huas nr. ***, datë 10.6.1996, janë kryer veprimet financiare si vijon:

a. Në monedhën DRM greke:

- depozituar kapital në datën 10.6.1996 shuma 300,000.0 DRM;
- depozituar kapital në datën 4.7.1996 shuma 3,000,000.0 DRM;
- depozituar kapital në datën (mandatarkëtim nr. ***, datë 30.8.1996) shuma 504,000.000.0 DRM;
- depozituar kapital në datën (mandatarkëtim nr. ***, datë 30.8.1996) shuma 1,500,000.0 DRM;
- depozituar kapital në datën (mandatarkëtim nr. ***, datë 20.10.1996) shuma 728,600.000.0 DRM;
- depozituar kapital në datën (mandatarkëtim nr. ***, datë 30.12.1996) shuma 96,000.0 DRM;
- depozituar kapital në total shuma 6,997,600.0 DRM;
- tërhequr kapital (mandatpagesë nr. **, datë 4.1.1997) – 3,000,000 DRM;
- tërhequr interesa në total për vitin 1996 shuma 2,645,600 DRM.

b. Në monedhën lekë:

- depozituar kapital në total për vitin 1996 shuma 200,000 lekë;
- tërhequr interesa në total shuma 37,120 lekë.

c. Në monedhën USD:

- depozituar kapital në total në vitin 1996 shuma 3,320 USD;
- tërhequr interesa në total shuma 1,143 USD.

33.2. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, provat e paraqitura prej tij, por edhe dokumentacionin e administruar gjatë hetimit, konstaton se provohet me dokumentacion provues se shuma 3,000,000 DRM ka qenë e depozituar në vitin 1996 tek shoqëria “V.H”, si

dhe prindërit e bashkëshortes kanë përfituar shumën 2,645,600 DRM si interesa nga kjo shoqëri. Në lidhje me këto të ardhura të krijuara nga firmat piramidale, Komisioni mban në konsideratë edhe vendimin nr. 15/2021 të Kolegjit.

33.3. Subjekti ka lidhur martesë ligjore në datën 25.7.2001, për rrjedhojë shuma 3,000,000 DRM rezulton të jetë krijuar përpara martese nga bashkëshortja e subjektit. Gjithashtu, kjo shumë rezulton të jetë krijuar përpara fillimit të detyrës nga subjekti. Komisioni vlerëson se dokumentacioni i depozituar nga subjekti dhe ai i administruar gjatë hetimit administrativ konsiderohet i mjaftueshëm për të përfshirë në analizë financiare shumën 3,000,000 DRM, pasi provohet që prindërit e bashkëshortes së subjektit kanë përfituar interesat nga huadhënia në shumën 2,645,600 DRM + 1,143 USD + 37,120 lekë, si dhe kanë tërhequr shumën e dhënë hua prej 3,000,000 DRM.

33.4. Në vlerësimin përfundimtar të kësaj çështjeje, Komisioni i është referuar:

(i) vendimit nr. 20/2019 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelit: “[...] për sa kohë që personat e tjerë të lidhur nuk janë subjekte rivlerësimi, analiza dhe vlerësimi i pasurisë së tyre duhet të bëhet në kufijtë e pasurisë së dhënë hua apo dhuruar dhe sipas një vlerësimi logjik e të arsyeshëm, referuar rasteve konkrete e rrethanave specifike të tyre, përveç rasteve të ekzistencës së dyshimeve për pasuri të fshehura në emër të personave të tjerë të lidhur [...]”;

(ii) vendimit nr. 15/2019 (JR), të Kolegjit të Posaçëm të Apelit: “[...] në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar prej nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur. Interpretimi në të kundërt i kësaj dispozite konsiderohet se shkel parimin e proporcionalitetit, pasi e ngarkon subjektin me një barrë përtej asaj që ai ligjërisht është ngarkuar të mbajë dhe barazon statusin e një shtetasi tjetër, personit tjetër të lidhur, që përgjithësisht nuk ka figuruar të ketë qenë subjekt deklarues, me atë të vetë subjektit të rivlerësimit, një mision që del jashtë qëllimit të ligjit e, për më tepër, duket edhe i pamundur. Pavarësisht, ky arsyetim në asnjë rast nuk duhet të pengojë organet e rivlerësimit që të hetojnë çdo situatë të dyshuar se personat e tjerë të lidhur mbajnë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit apo se janë përdorur për të fshehur ekzistencën e një marrëdhënieje që të çon në një situatë konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me një person tjetër, dyshim i cili duhet të ngrihet mbi rrethana objektive”.

34. Analizë financiare

	Vitet 1996 – 2001
Pasuria	5,672,881.34
Apartament me sip. 111.6 m ² , Tiranë	4,964,007.96
Ndryshim likuiditeti	708,873.38
Detyrime	0.00
Pasuria neto	5,672,881.34
Të ardhura	6,355,338.46
Të ardhurat e subjektit	2,406,288.00
Të ardhurat e bashkëshortes	1,288,240.00
Të ardhura nga interesat e depozitave	26,410.46
Të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme	1,000,000.00
Dhurim nga prindërit e bashkëshortes 3 milionë DRM	1,634,400.00
Shpenzime	1,012,912.26

Shpenzime jetike	1,012,912.26
<i>TIMS</i>	0.00
Mundësia për kursime	-330,455.14

Në analizë financiare janë përfshirë:

- i) të ardhurat nga puna e subjektit dhe e bashkëshortes;
- ii) të ardhurat nga shitja e apartamentit me kontratën nr. ***, datë 21.5.1997, në vlerën 1,000,000 lekë;
- iii) të ardhurat nga puna e prindërve të bashkëshortes së subjektit në vlerën 3,000,0000 dhrahmi.

35. Nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur mundësi financiare për blerjen e këtij apartamenti në shumën 330,455.14 lekë.

36. Pas kalimit të barrës së provës subjekti ka prapësuar se në analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitet 1996 – 2001 nuk janë përfshirë të ardhurat prej 61,760 lekësh, të përfituara nga puna e tij në Ministrinë e Punëve të Jashtme, por është përfshirë vetëm shuma që i përket 4 muajve të vitit 1996. Subjekti thekson se në këtë ministri ka përfituar gjithashtu edhe të ardhura nga dietat për shërbime jashtë shtetit, por që nuk janë deklaruar për mungesë dokumentacioni provues.

36.1. Në prapësimet e tij subjekti ka pretenduar se në përlogaritjen e shpenzimeve jetike për dy persona për vitet 1996 – 2001 Komisioni është bazuar te niveli i shpenzimeve për frymë, duke iu referuar shkresës nr. *** prot., datë 29.1.2019, të ILDKPKI-së, sipas së cilës shpenzimet vjetore për dy persona figurojnë në masën 22-23% të të ardhurave vjetore. Në analizën financiare për vitet 1996 – 1999 shpenzimet vjetore për dy persona janë llogaritur në masën 33% të të ardhurave vjetore, ndërkohë që për këtë periudhë niveli i jetesës ka qenë më i ulët dhe duhet të konsiderohet ruajtja e të njëjtit raport shpenzime/të ardhura në nivelin 22%. Sipas subjektit, duke konsideruar këtë rivlerësim, balanca negative do të reduktohej nga 330,455 lekë në 145,818 lekë.

36.2. Subjekti ka pretenduar gjithashtu se Komisioni duhet të mbajë në konsideratë faktin se një pjesë e parave që kanë shërbyer për pagimin e kësteve të viteve 1999 dhe 2000 janë konvertuar më parë me një kurs më të favorshëm se ai i përlogaritur në analizën financiare.

37. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se pretendimi i tij lidhur me konvertimin e një pjese të parave që kanë shërbyer për pagesat e kryera për blerjen e apartamentit në periudhë më të hershme, si dhe të ardhurat e përfituara nga dietat për shërbime jashtë shtetit, mund të jenë bindëse, por nuk mbështeten në dokumentacion provues.

37.1. Në lidhje me përlogaritjen e shpenzimeve vjetore të subjektit dhe personave të lidhur me të në vitet 1996 – 1999, ashtu siç prapëson edhe vetë subjekti, rezulton se edhe nëse shpenzimet jetike në këto vite do të përlogariteshin në masën 22%, mundësia për kursime e subjektit do të ishte sërish me balancë negative në vlerën 145,818 lekë.

38. Në përfundim, duke marrë në konsideratë vlerën e ulët të mungesës së burimeve të ligjshme për këtë pasuri, kohën e krijimit të kësaj pasurie përpara fillimit të detyrës së subjektit, duke iu referuar edhe paragrafit 96 të vendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) S vs Albania, parë nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit,

Komisioni vlerëson se kjo shumë nuk klasifikohet si deklaram i pamjaftueshëm për të shërbyer si shkak autonom për shkarkimin e subjektit nga detyra.

39. Apartament¹¹ me sipërfaqe 68², h. *, ap. **, në Lagjen **, P, D, krijuar në vitin 2008, regjistruar në vitin 2013, me vlerë 30,000 euro

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: të ardhura nga puna dhe kredi bankare në shumën 10,000 euro, shlyer në vitin 2015.

Hetimi¹²/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

40. Me kontratë shitjeje me kusht nr. ***, datë 13.2.2008, subjekti ka blerë apartament me sip. 72 m², ndodhur në Lagjen **, P, D, për çmimin 30,000 euro.

41. Referuar përmbajtjes së kontratës rezulton se palët kanë dakordësuar që çmimi i shitjes së këtij apartamenti do të likuidohet si vijon:

- vlera 15,000 euro do të likuidohet jashtë zyrës noteriale, në ditën e lidhjes së kontratës;
- vlera 10,000 euro do të likuidohet nga pala blerëse në momentin e aprovimit të një kredie bankare;
- vlera 5,000 euro do të likuidohet në momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitblerjes.

42. Në datën 28.10.2013 palët kontraktuese kanë nënshkruar deklaratën noteriale nr. ***, në përmbajtje të së cilës shitësi deklaron se *vlera e mbetur e shitjes së apartamentit¹³ është likuiduar nga blerësi jashtë zyrës noteriale në muajin dhjetor të vitit 2008, duke konsideruar kështu të përmbushur kushtin e vendosur në kontratën e shitjes nr. *** datë 13.2.2008.*

42.1. Kjo deklaratë noteriale rezulton e depozituar pranë ASHK Durrës dhe ka mundësuar pajisjen e subjektit të rivlerësimit me certifikatën e pronësisë datë 26.11.2013, në të cilën ai dhe bashkëshortja rezultojnë bashkëpronarë të pasurisë nr. ***, z. k. ***.

43. Subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën e interesave privatë pas largimit nga funksioni në vitin 2008, të nënshkruar prej tij në datën 24.3.2009, me përshkrimin “Kontratë shitjeje me kusht për apartamentin me sip. 72 m², ndodhur në Lagjen **, P, D, paguar 15,000 euro në datën 13.2.2008. Pasuri e paregjistruar, burim të ardhurat familjare nga puna. Vlera e plotë e pasurisë 30,000 euro”.

43.1. Gjithashtu, në rubrikën “detyrime financiare” të kësaj deklarate, subjekti ka deklaruar: *“Kredi për apartament 10,000 euro, datë 18.4.2008 – 18.4.2018, nga e cila është shlyer vlera 1,200 euro dhe ka mbetur pa shlyer vlera 13,000 euro”.*

¹¹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) kontratë shitjeje me kusht nr. *** rep., nr.*** kol., datë 13.2.2008; (ii) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 26.11.2013; (iii) deklaratë datë 19.1.2017 nga “Alpha Bank”.

¹² Shkresë nr. *** prot., datë 19.10.2020, drejtuar ASHK-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 19.10.2020, nga ASHK Durrës; shkresë nr. *** prot., datë 27.5.2022, drejtuar ASHK-së Durrës; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.6.2022, nga ASHK Durrës; shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2019, drejtuar FSHU-së; kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 2.10.2020, nga FSHU-ja; shkresë nr. *** prot., datë 9.8.2017, e ZQRPP-së drejtuar ILDKPKI-së; shkresë nr. *** prot., datë 25.9.2020 drejtuar ILDKPKI-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 25.9.2020, e ILDKPKI-së; shkresë nr. *** prot., datë 25.9.2020 drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 6.7.2022 dhe nr. *** prot., datë 25.9.2020, e “Alpha Bank”.

¹³ Duke iu referuar kështu të fundit në vlerën 5,000 euro.

44. I pyetur nga ILDKPKI-ja në datën 4.2.2010¹⁴ në lidhje me këtë pasuri dhe me pagesat e kryera për blerjen e saj, subjekti ka sqaruar: “*Sipas kontratës së shitjes me kusht, kësti i fundit prej 5,000 euro do të paguhet në momentin e realizimit të kontratës së shitjes dhe regjistrimit në ZVRPP. Vlera e paguar prej 15,000 euro nuk është e përfituar vetëm nga të ardhurat e deklaruar të vitit të fundit, por edhe të kursimeve ndër vite, të padepozituara në bankë...*”.

45. Komisioni ka pyetur subjektin e rivlerësimit në lidhje me këtë deklaram të tij në vitin 2010. Në përgjigje të pyetësorit të datës 31.10.2022, subjekti ka sqaruar se në shkurt të vitit 2010 është pyetur nga punonjësit e ILDKPKI-së në lidhje me burimin e kësaj pasurie, ku ka saktësuar se të ardhurat për këtë pasuri kanë qenë edhe kursimet e padepozituara në bankë ndër vite. Duke mbajtur në konsideratë sqarimin e dhënë në ILDKPKI, në plotësimin e deklaratës *Vetting* ai ka deklaruar burimin e kësaj pasurie me të ardhura nga puna, duke pasur parasysh të ardhurat familjare ndër vite, si vijon:

- të ardhura nga Universiteti i B në shumën 1,170 euro;
- të ardhura nga puna si ekspert në *T.L.A.S.*, në shumat 2,000 USD dhe 207,360 lekë në vitin 2004 dhe 2,400 USD në vitin 2007;
- të ardhura nga mësimdhënia në universitetin “A.U”, në shumën 485,250 lekë;
- të ardhura nga mësimdhënia në universitetin “J *”, në shumën 362,020 lekë;
- të ardhura nga mësimdhënia në universitetin “K”, në shumën 532,500 lekë;
- të ardhura nga puna si ekspert me *U.N.I.C and J.R.I* (UNCRI), në shumën 3,600 euro.

Në një llogaritje të përafërt bazuar në të ardhurat e krijuara më lart, subjekti deklaroi se mund të ketë pasur gjendje rreth 2,000,000 lekë *cash* në shtëpi në vitin 2007, e cila ka shërbyer si burim për të blerë këtë apartament.

46. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstatoi se ai nuk ka deklaruar kursime *cash* gjatë viteve 2003 – 2008, pavarësisht mundësisë së tij për krijimin e këtyre kursimeve dhe, për këtë arsye, nuk i përfshiu këto kursime në analizë financiare, duke i kërkuar subjektin të japë shpjegime bindëse në lidhje me ekzistencën e tyre.

47. Në lidhje me këto kursime *cash*, në prapësimet e tij subjekti ka argumentuar arsyet përse Komisioni duhet të njohë të ardhurat e përfituara prej tij nga mësimdhënia dhe angazhimi si ekspert gjatë viteve 2003 – 2007, në vlerën totale 1,746,972.90 lekë. Ai sqaron se apartamenti në Durrës është blerë në vitin 2008 dhe është deklaruar në deklaramin vjetor të këtij viti. Më tej, në shkurt të vitit 2010 ai ka dhënë sqarime pranë ILDKPKI-së në lidhje me burimin e kësaj pasurie, ku ka saktësuar dhe detajuar se të ardhurat për këtë pasuri kanë qenë edhe kursimet e padepozituara në bankë ndër vite. Subjekti citon edhe një herë të ardhurat e përfituara nga mësimdhënia dhe angazhimi si ekspert deri në vitin 2008, në vlerë totale rreth 2,000,000 lekë, e cila është mbajtur *cash* në banesë në vitin 2007 dhe kanë shërbyer si burim për blerjen e këtij apartamenti.

48. Komisioni, për sa i përket pasaktësive në deklaramat periodike vjetore të subjektit në lidhje me mosdeklaramin e gjendjes *cash*, në mbështetje të qëndrimit të mbajtur nga Kolegji¹⁵ në çështje të ngjashme, e cila përbën tashmë jurisprudencë të konsoliduar të tij, vlerëson se një deklaram i pasaktë në deklaramet e mëparshme periodike të interesave, i pashoqëruar me mungesë burimesh të ligjshme financiare, nuk mund të konsiderohet se është bërë në

¹⁴ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 25.9.2020, e ILDKPKI-së.

¹⁵ Vendimet: nr. 9/2020 (JR); nr. 16/2022 (JR); nr. 37/2021 (JR); nr.20/2022 (JR); nr. 33/2021 (JR); nr. 1/2022 (JR).

kundërshtim me përcaktimin e germës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë, nuk është element i mjaftueshëm për t’u konsideruar si një shkak i vetëm dhe i veçantë që prodhon situatën e deklarimit të pamjaftueshëm, në kuptim të pikës 3 të nenit 61 të këtij ligji. Për më tepër, këto pasaktësi janë korigjuar nga subjekti pranë organit përgjegjës të ILDKPKI-së, i cili me *email* të datës 15.2.2010 ka saktësuar burimin e kësaj pasurie, duke deklaruar se vlera e paguar prej 15,000 euro nuk është e përfituar vetëm nga të ardhurat e deklaruarat të vitit të fundit, por edhe të kursimeve ndër vite, të padepozituara në bankë. Komisioni vëren se ky akt është hartuar në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9049/2003, i cili parashikon se: *“Kur gjatë kontrollit zbulohet se deklaratimet nuk janë të sakta ose burimet e deklaruarat nuk identifikohen, nuk mbulojnë pasuritë e deklaruarat, Inspektori i Lartë thërret subjektin për të dhënë shpjegime të hollësishme dhe argumentet përkatëse, të cilat paraqiten kurdoherë me shkrim brenda 15 ditëve nga dita e njoftimit”*. Komisioni vlerëson me rëndësi të nënvizojë faktin se përpilimi i këtij *email*-i jo vetëm që është bërë nga organi kompetent në përputhje me procedurën e kërkuar prej ligjit, por ai daton në një kohë të largët dhe pa lidhje me kontekstin e procesit të rivlerësimit e në zbatim të tagrave ligjorë të tij, duke krijuar bindjen se të dhënat e përfituara në këtë *email*, nëpërmjet shpjegimeve të dhëna nga subjekti, kanë shëruar pasaktësitë në deklarime të subjektit të rivlerësimit në funksion të zbatimit të ligjit nr. 9049/2003, në mënyrë autonome nga procesi i rivlerësimit. Në këtë kontekst, Komisioni çmon se vlera provuese e këtyre deklaratimeve në këtë çështje është e rëndësishme dhe nuk mund të anashkalohet nën frymën e një shqyrtimi objektiv të çështjes. Në zbatim të parashikimit kushtetues të nenit Ç, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, organet e rivlerësimit kanë detyrimin të shqyrtojnë deklaratat e subjektit për të shkuarën e tij dhe sigurisht të përcaktojnë vlerën e tyre provuese në raport e harmoni me të gjitha rrethanat e faktit që rezultojnë nga burime të tjera. Në këtë këndvështrim, këto shpjegime të subjektit të dhëna në të kaluarën e tij, e pikërisht në funksion të sqarimit të pasaktësive në plotësimin e deklaratave periodike të tij përpara institucionit të vetëm përgjegjës për deklarimin e pasurive, nuk mund të abstrahohen dhe të konsiderohen inekzistente, si akte që japin informacion relevant për çështjet e procesit të tij të rivlerësimit.

Në analizë të sa më sipër, Komisioni vlerëson të konsiderojë në analizë financiare mundësinë e kursimeve *cash* të subjektit të rivlerësimit sipas burimeve të deklaruarat prej tij.

49. Në lidhje me kredinë bankare në vlerën 10,000 euro, marrë në “Alpha Bank”, nga hetimi ka rezultuar se me kontratën “për kufi kredie shumëqëllimore” nr. ***, datë 1.4.2008, subjekti dhe bashkëshortja, në cilësinë e kredimarrësve kanë çelur pranë “Alpha Bank” kufirin e kredisë¹⁶ në shumën 10,000 euro, për një afat të pacaktuar. Kjo kontratë është nënshkruar gjithashtu nga znj. S.P¹⁷, në cilësinë e dorëzantës.

49.1. Me kontratën nr. ***, datë 1.4.2008, të emërtuar “shtesë e kontratës për kufi kredie shumëqëllimore” subjekti dhe bashkëshortja kanë përdorur shumën 10,000 euro me qëllim “blerjen e apartamentit”. Në përmbajtje të kontratës citohet se kostoja e përgjithshme e projektit që po financohet nga banka është në vlerën 30,000 euro. Huaja është dhënë për një afat 10-vjeçar.

49.2. Referuar lëvizjeve bankare rezulton se kredia në vlerën 10,000 euro është lëvruar në llogarinë e kredimarrësve P në datën 18.4.2008 dhe po në këtë datë është transferuar në

¹⁶ Kredia është garantuar përmes marrëveshjeve të pengut si vijon: “Marrëveshje pengu nr. ***, datë 11.4.2008, përmes së cilës Sokol e M.P kanë bllokuar në favor të bankës shumën 3,034.12 USD në llogarinë e tyre pranë kësaj banke” dhe “Marrëveshje pengu nr. ***, datë 8.4.2008, përmes së cilës S.P ka bllokuar në favor të bankës shumën 14,457.6 USD në llogarinë e saj pranë kësaj banke”.

¹⁷ Motra e subjektit të rivlerësimit.

Ilogarinë bankare të z. A.Q me referencë “Sa kaluar nga Sokol a M.P për A.Q, likuidim përfundim për blerje apartamenti”.

50. Analizë financiare

APARTAMENT NË DURRËS	Viti 2008
Pasuri	3,927,990.27
Apartament me sip. 68 m ² , D	3,695,475.00
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>232,515.27</i>
Total likuiditeti	2,049,422.57
Detyrime	1,156,326.45
Kredi në “Alpha Bank”	1,231,825.00
Pagesë e principalit të kredisë në “Alpha Bank”	-75,498.55
Pasuria neto	2,771,663.83
Të ardhura	3,228,685.68
Të ardhurat e subjektit	2,363,885.34
Të ardhurat e bashkëshortes	797,278.00
Të ardhura nga interesat e depozitave	67,522.34
Shpenzime	847,571.52
Shpenzime jetike	546,480.00
<i>TIMS</i>	<i>245,955.03</i>
Shpenzime disbursimi dhe/ose mbyllje kredie në “Alpha Bank”	9,238.69
Shpenzime për pagesën e interesit të kredisë në “Alpha Bank”	45,897.80
Mundësia për kursime	-390,549.66

51. Nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur mundësi financiare për blerjen e këtij apartamenti në shumën 390,549.66 lekë.

52. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti prapësoi duke pretenduar që në analizën financiare të vitit 2008 të përfshihen kursimet *cash* në shumën 2,000,000 lekë ose të paktën në vlerën e rezultatit negativ, çka do të bënte që rezultati i analizës financiare të ishte pozitiv. Ai i kërkon Komisionit të mbajë në konsideratë faktin se gjatë kësaj periudhe nuk ka kryer investime të tjera.

53. Nga shqyrtimi i provave dhe shpjegimeve të subjektit rezulton se pasaktësia e subjektit në deklarimin e gjendjes *cash* është qartësuar në deklarimin e bërë prej tij në vitin 2010 pranë ILDKPKI-së. Gjithashtu, nga analiza e kryer nga Komisioni, rezultoi se subjekti ka pasur mundësi për kursime *cash* në shumën 4,353,598.26 lekë.

54. Në përfundim, Komisioni, bazuar në argumentimin në paragrafin 48 të këtij vendimi, ka përfshirë në analizë financiare gjendjen *cash* të subjektit në masën e rezultatit negativ.

54.1. Për pasojë, konstatohet se subjekti ka kryer deklarim të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.

54.2. Përveç sa më sipër, edhe sikur të mos konsiderohen kursimet *cash* të subjektit të rivlerësimit, Komisioni, duke marrë në konsideratë vlerën e ulët të pamundësisë financiare të subjektit, kohën e krijimit të kësaj pasurie përpara fillimit të detyrës duke iu referuar dhe

paragrafit 96 të vendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) S vs Albania, parë nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, vlerëson se kjo shumë nuk klasifikohet si deklaram i pamjaftueshëm për të shërbyer si shkak autonom për shkarkimin e subjektit nga detyra.

55. Automjet¹⁸ tip “M-B”, vit prodhimi 2002, krijuar në vitin 2013, me vlerë 1,800 euro + 54,704 lekë taksa doganore dhe TVSH. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës Vetting: të ardhura nga puna.

Hetimi¹⁹/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

56. Me dokument shitjeje automjeti në gjuhën gjermane, subjekti ka blerë automjetin e llojit “M-B”, vit prodhimi 2002, për çmimin 1,800 euro. Referuar deklaratës doganore Import 4, datë 5.5.2014, ky automjet është zhdoganuar kundrejt vlerës 54,704 lekë nga importuesi Sokol Pasho.

57. Subjekti e ka deklaruar blerjen e këtij automjeti në DPV/2014 me të njëjtin përshkrim si në deklaratën *Vetting*.

58. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë pasur mundësi financiare për blerjen e automjetit.

59. Në përfundim konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri. Subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.

60. Depozitë²⁰ me vlerë 13,500 euro + 1,500 euro në “Union Bank”. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës Vetting: të ardhura nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor nr. ***, datë 17.3.2014.

Hetimi²¹/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

61. Bazuar në nxjerrjen e llogarisë së subjektit në “Union Bank” rezulton se në datën 8.3.2016 subjekti ka depozituar shumën 1,500 euro, duke i kaluar këto fonde në depozitë me afat 12-mujor. Më tej, në datën 21.3.2016 subjekti ka depozituar shumën 13,500 euro, duke i kaluar këto fonde në depozitë me afat 12-mujor. Si burim për këto depozitime subjekti ka deklaruar të ardhurat nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor nr. ***.

62. Në përgjigje të pyetësorit datë 12.7.2022, subjekti ka vendosur në dispozicion të Komisionit dokumentacionin e plotë që lidhet me vendimin gjyqësor dhe ekzekutimin e tij. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni rezulton se:

i. Në datën 5.2.2014 pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë është regjistruar çështja gjyqësore me palë paditëse subjektin e rivlerësimit dhe palë të paditur institucionin e Avokatit të Popullit, me objekt “dëmshpërblimin me pagën e një viti pune për zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar, pagën e një muaj për mosrespektim të

¹⁸ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: deklaratë doganore për blerje automjeti tip “M-B C***CDI”, çmim i taksueshëm 273,526 lekë, DAV 54,704 lekë.

¹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar DPSHTRR-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 30.9.2020, e DPSHTRR-së.

²⁰ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: pozicionin e klientit lëshuar nga “Union Bank” në datën 16.10.2016.

²¹ Shkresë nr. *** prot., datë 25.9.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 29.9.2020, e “Union Bank”.

afatit të njoftimit dhe pagën e dy muajve për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës”. Me vendimin e datës 17.3.2014 gjykata ka vendosur “Pranimin e padisë së paditësit Sokol Pasho”. Ky vendim është ankimuar nga pala e paditur dhe Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”.

ii. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar këtë vendim gjyqësor për ekzekutim pranë shoqërisë përmbarimore “**** Group” sh.p.k. Sipas vendimit datë 22.1.2016, për “pushimin e ekzekutimit” të shoqërisë përmbarimore rezulton se debitori ka përmbushur tërësisht detyrimin ndaj kreditorit Sokol Pasho.

iii. Sipas mandatpagesës datë 26.1.2016 rezulton se subjekti i rivlerësimit ka tërhequr nga llogaria bankare e shoqërisë “**** Group” sh.p.k. vlerën 2,102,819 lekë.

63. Nga analizimi i dokumentacionit të mësipërm rezulton se vlera prej 2,102,819 lekësh e përfituar nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor, e konvertuar në monedhën euro, ka shërbyer si burim për depozitimet e vlerave 13,500 euro dhe 1,500 euro në datën 8.3.2016, në llogarinë rrjedhëse të subjektit pranë “Union Bank”.

64. Në përfundim konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të subjektit. Subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e kësaj depozite.

65. Depozitë²² në vlerën 3,414.39 USD në “Alpha Bank”. Pjesa takuese: 50%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: të ardhura nga puna.

Hetimi²³/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

66. Nga dokumentacioni i administruar nga “Alpha Bank” rezulton se subjekti ka hapur një llogari dyemërore me vajzën e tij E.P në vitin 2002, në shumën 500 USD, në të cilën ai ka vijuar të kryejë depozitime dhe në datën 31.12.2007 gjendja e kësaj llogarie është në vlerën 3,353.96 USD. Në datën 18.4.2008 ai ka hapur depozitë dyemërore së bashku me bashkëshorten në vlerën 3,034 USD. Kjo shumë është transferuar në datën 2.3.2009 në depozitë me afat 12-mujor dhe pas maturimit vlera e saj në datën 23.1.2017 është 3,141.39 USD.

67. Në përfundim konkludohet se subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj depozite.

68. Depozitë²⁴ në vlerën 5,929.73 USD në “Alpha Bank” në emër të vajzës E.P

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: të ardhura nga puna.

Hetimi²⁵/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

²² Subjekti ka depozituar dokumentin pozicion i klientit lëshuar nga “Alpha Bank”, datë 19.1.2017.

²³ Shkresë nr. *** prot., datë 25.9.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë nr. *** prot., datë 6.7.2022 dhe nr. *** prot., datë 25.9.2020, e “Alpha Bank”; shkresë nr. *** prot., datë 12.7.2022, drejtuar “Alpha Bank”; shkresë kthim përgjigjeje nr. ***, datë 2.8.2022, e “Alpha Bank”.

²⁴ Subjekti ka depozituar dokumentin pozicion i klientit lëshuar nga “Alpha Bank”, datë 19.1.2017.

²⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 25.9.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë nr. *** prot., datë 25.9.2022 dhe nr. *** prot., datë 25.9.2020, e “Alpha Bank”.

69. Nga dokumentacioni i administruar nga “Alpha Bank” rezultoi se subjekti së bashku me vajzën e tij E.P kanë çelur një depozitë me nr. ***, me afat 12-mujor, e cila datën 31.12.2009 rezulton me gjendje 2,251.18 USD.

70. Në datën 8.9.2010 bashkëshortja e subjektit ka depozituar në llogarinë e saj në “Alpha Bank” shumën 13,000 USD, të cilat i ka mbyllur në depozitë me afat 12-mujor.

71. Në datën 8.9.2011 bashkëshortja e subjektit e ka mbyllur këtë depozitë dhe e ka transferuar shumën 3,262 USD në llogarinë e vajzës E.P, nën komentin “kalim nga M.P tek E.P”. Gjendja e depozitës në datën 8.9.2011 rezulton të jetë 5,610 USD dhe pas maturimit vlera e saj më 23.1.2017 rezulton të jetë 5,929.72 USD.

72. Depozitë në vlerën 10,000 euro në “Credins Bank”²⁶

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: të ardhura nga puna.

Hetimi²⁷/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

73. Nga dokumentacioni i administruar nga “Credins Bank” rezultoi se në datën 13.1.2017 subjekti i rivlerësimit ka hapur depozitë me afat 12-mujor, duke depozituar shumën 10,000 euro, nën përshkrimin “derdh Sokol Pasho nga puna e kryer”.

74. Në po këtë datë bashkëshortja e subjektit ka hapur një depozitë në “Intesa Sanpaolo Bank”²⁸ me afat 12-mujor, duke depozituar shumën 10,000 euro, nën përshkrimin “cash depozitë M. P, kursime nga puna”.

75. Në lidhje me këto dy depozita Komisioni i ka kërkuar subjektit të saktësonte burimin e tyre. Në përgjigje të pyetësorit të datës 31.10.2022, subjekti ka sqaruar se: *“Në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2011, ai ka deklaruar kursime cash në shumën 7,500 euro, e cila ka pasur si burim të ardhurat nga paga të vitit 2011, por edhe një pjesë të gjendjes cash nga vitet e kaluara. Në lidhje me deklaratimet e gjendjes cash, ka deklaruar shtesa të kursimeve cash dhe në vitin pasardhës 2012 në shumën 500,000 lekë dhe gjendje në llogari në shumën 400,000 lekë. Në vitet në vazhdim ka deklaruar gjendjet në bankë, të cilat i ka tërhequr në vitet pasardhëse. Në vitin 2013 ka deklaruar shumën 420,883.44 lekë, gjendje llogarie e cila është tërhequr në vitin 2014. Në deklaratën periodike të vitit 2014 ka deklaruar shumën 456,773 lekë, gjendje llogarie e cila është tërhequr në vitin 2015. Në deklaratën periodike të vitit 2015 ka deklaruar shumën 330,188 lekë, gjendje llogarie e cila është tërhequr në vitin 2016. Gjatë vitit 2016 ka krijuar të ardhura të konsiderueshme, ku, ndër të tjera, ka përfutuar në datën 26.1.2016 shumën 2,102,819 lekë, nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor nr. ***, datë 17.3.2014, për dëmshpërblim për zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar. Këtë shumë e ka përdorur për të krijuar depozitat në ‘Union Bank’ në shumën 13,500 euro dhe 1,500 euro. Përveç të ardhurave të mësipërme, së bashku me bashkëshorten kanë pasur të ardhura të konsiderueshme nga puna, duke tërhequr nga bankat gjatë gjithë viti 2016 një shumë totale prej rreth 3,100,000 lekësh. Nga tepricat e mbetura nga shumat e tërhequra nga bankat, së bashku me kursimet cash të viteve të mëparshme, ka krijuar në datën 13.1.2017 dy depozita në shumën totale 20,000 euro. Këto dy depozita janë krijuar në*

²⁶ Subjekti ka depozituar konfirmim datë 20.1.2017, të “Credins Bank”.

²⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 25.9.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë nr. *** prot., datë 28.12.2020, e “Credins Bank”.

²⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 25.9.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë nr. *** prot., datë 1.10.2020, e “Intesa Sanpaolo Bank”.

momentin e plotësimit të deklaratës Vetting si detyrim ligjor i parashikuar nga ligji nr. 84/2016, sipas të cilit nuk lejoheshin kursime cash në shumën mbi 1,500,000 lekë. Kjo ka qenë edhe arsyeja që në deklaratën Vetting ai nuk ka deklaruar kursime cash, si dhe shtesa në deklaratën periodike të vitit 2016, pasi të gjitha kursimet janë përdorur për hapjen e dy depozitave në datën 13.1.2017. Në momentin që është plotësuar deklarata periodike vjetore e vitit 2016 në mars të vitit 2017, duke qenë se të gjitha kursimet ishin depozituar në bankë që më 13.1.2017, mund të jetë treguar i pakujdesshëm për ta specifikuar këtë fakt dhe e ka gjykuar si të ezauruar në deklaratën Vetting”.

76. Komisioni verifikoi deklarata periodike të subjektit, nga ku rezulton se ka deklaruar si vijon:

- në DPV/2011 – kursime cash 7,500 euro;
- në DPV/2012 – vlera 500,000 lekë kursime nga të ardhurat personale dhe 400,000 lekë kursime nga të ardhura personale në “Credins Bank”;
- në DPV/2013 – vlera 420,883.44 lekë gjendje llogarie, e cila konfirmohet si gjendje llogarie nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në “Credins Bank”;
- në DPV/2014 – vlera 456,773 lekë gjendje llogarie, e cila konfirmohet si gjendje llogarie nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në “Credins Bank”;
- në DPV/2015 – vlera 330,188 lekë gjendje llogarie, e cila konfirmohet si gjendje llogarie nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në “Credins Bank”.

77. Analizë financiare për krijimin e këtyre depozitave

	Datë 31.1.2017
Pasuria	-1,358,508.49
Depozita	2,659,000.00
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>-4,017,508.4917</i>
<i>Total likuiditeti</i>	<i>1,827,755.33</i>
Detyrime	0.00
Pasuria neto	-1,358,508.49
Të ardhura	333,373.40
Të ardhurat e subjektit	106,236.00
Të ardhurat e bashkëshortes	153,675.00
Të ardhura nga interesat e depozitave	73,462.40
Shpenzime	79,351.35
Shpenzime jetike	79,351.35
Mundësia për kursime	1,612,530.54

Në këtë analizë nuk është përfshirë shuma 1,200,000 lekë e deklaruar si tërheqje e shumave të gjendjeve të llogarive bankare të deklaruara në deklaratat periodike vjetore. Pas dërgimit të rezultateve të hetimit subjekti ka pretenduar se kjo shumë duhet të përfshihet në analizë financiare, për sa kohë që kjo analizë rezulton me një rezultat pozitiv për të gjitha vitet në të cilat ka krijuar kursime cash, si dhe referuar paragrafit 10/12 të vendimit nr. 37/2021 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Në lidhje me këto pretendime të subjektit Komisioni vlerëson të mos kryejë një analizim të tyre, për sa kohë nuk kanë ndikim në vlerësimin e kriterit të pasurisë (për sa kohë nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të

ligjshme për krijimin e këtyre dy depozitave) dhe për më tepër Komisioni nuk i ka kaluar barrë prove apo i ka kërkuar shpjegime subjektit.

78. Në përfundim konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të subjektit. Subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e këtyre depozitave.

79. Gjendje në llogarinë e pagës, datë 19.1.2017, në “Credins Bank”, në vlerën 396,857.76 lekë

80. Nga dokumentacioni i administruar nga “Credins Bank” rezulton se subjekti i rivlerësimit ka llogari rrjedhëse në lekë, në të cilën i kreditohet paga prej datës 3.1.2012 deri në datën 20.3.2019, ku rezulton që kjo llogari të jetë mbyllur prej tij. Gjendja e llogarisë në datën 23.1.2017 rezulton të jetë 396,857.76 lekë.

81. Në përfundim të hetimit konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari.

PASURITË E BASHKËSHORTES SË SUBJEKTIT

82. Apartament²⁹ me sipërfaqe 53.65 m², p. *, h. *, ap. *, në rrugën “M.Sh”, Tiranë. Vlera: 7,971 lekë.**

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: kontratë shitblerjeje datë 8.1993 me NKBanesa, me pjesë takuese 1/3.

Hetimi³⁰/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

83. Me kontratë shitblerjeje datë 8.1993, bashkëshortja e subjektit dhe prindërit e saj K dhe M. K kanë blerë nga NKBanesa apartamentin me sip. 53.65 m², nr. *, të ndodhur në pallatin ***, rruga “M.Sh”, për çmimin 7,971 lekë. Bazuar në këtë kontratë, pasuria është regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve K, M dhe M.K sipas certifikatës së pasurisë datë 3.7.2015.

84. Nga aktet e depozituara nga ASHK-ja rezulton se në datën 7.11.2006 shtetasi K. K, në cilësinë e investitorit, ka kryer vetëdeklarim për objektin “shtesë anësore 5 kate, zotëroj katin e dytë”, me sip. 64.93 m², banim + ballkon.

85. Babai i bashkëshortes së subjektit, së bashku me banorët e tjerë të cilët kanë realizuar ndërtimin informal, kanë nënshkruar “kontratën e kalimit të pronësisë të parcelës ndërtimore” nr. ***, datë 14.1.2010, përmes së cilës kanë përfitur sip. 67.8 m² të parcelës ndërtimore mbi të cilën është ndërtuar objekti informal. Babai i bashkëshortes së subjektit ka paguar shumën 35,350 lekë për kalimin në pronësi të pjesës takuese të parcelës ndërtimore.

86. Në përfundim të hetimit konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri.

87. Gjendje në llogarinë e pagës, datë 19.1.2017, në “Intesa Sanpaolo Bank”, në vlerën 100,662.99 lekë

²⁹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën kontratën e shitblerjes lidhur me NKBanesa Tiranë.

³⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar ASHK-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 16.10.2020, e ASHK Tirana Jug.

Hetimi³¹/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

88. Nga dokumentacioni i administruar nga “Intesa Sanpaolo Bank” rezultoi se shtetasja M. P është kliente e kësaj banke me nr. **** dhe zotëron llogarinë rrjedhëse në lekë në të cilën i disbursohet paga prej datës 20.2.2008. Gjendja e llogarisë në datën 23.1.2017 rezulton të jetë 100,662.99 lekë.

89. Komisioni nuk ka konstatuar ndonjë parregullsi në lidhje me këtë llogari.

Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

90. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën *Vetting* pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

91. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit Sokol Pasho nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatoheshin parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

92. Komisioni vlerëson të ndalet edhe në rastin nëse në analizën financiare të subjektit nuk do të pranohen shpjegimet e subjektit për sa i përket pasaktësive në deklarin e gjendjes *cash*. Në këtë rast subjekti do të rezultonte me një mungesë burimesh financiare prej 721,004.81 lekësh. Duke mbajtur në konsideratë faktin se: (i) vlera e bilancit negativ për secilin vit zë një pjesë krahimisht të vogël në raport me vlerën e blerjes së pasurive objekt kontrolli; (ii) nga analiza financiare e kryer për çdo vit rezulton me balanca pozitive të të ardhurave dhe shpenzimeve në një shumë totale prej 11,680,370 lekë; (iii) kemi të bëjmë me dy pasuri të krijuara përpara fillimit të detyrës, referuar edhe jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit³² – kjo mungesë burimesh financiare nuk mund të konsiderohet si deklarim i pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

92.1. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Sokol Pasho ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLI I FIGURËS

93. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Sokol Pasho, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

³¹ Shkresë nr. **** prot., datë 25.9.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë nr. **** prot., datë 1.10.2020, e “Intesa Sanpaolo Bank”.

³² Vendimet nr. 24/2021, nr. 38/2021, nr. 17/2022 dhe nr. 27/2022.

94. Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit raportin³³ mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Sokol Pasho, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaratimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

95. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit. Ky qëndrim nuk ka ndryshuar edhe pas përditësimit të raportit nga ana e DSIK-së³⁴.

96. Komisioni kreu një hetim³⁵ të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetin të subjektit të rivlerësimit Sokol Pasho, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara rishtazi nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, edhe pas përditësimit të informacionit, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

97. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Sokol Pasho ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

98. Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLGJ-ja;
- kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- denoncimet e paraqitura pranë Komisionit.

Raporti i hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor

99. Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

³³ Raporti nr. *** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. **, datë 6.1.2021, të KDZH-së.

³⁴ Raporti i përditësuar me nr. *** prot., datë 23.6.2022, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 25.8.2022, të KDZH-së.

³⁵ Shihni dosjen me informacion të klasifikuar të subjektit të rivlerësimit.

100. Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; (ii) pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

101. Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; si dhe (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

102. Nga verifikimi i tri dokumenteve ligjore të depozituara nga subjekti nuk u konstatuan problematika.

103. Nga analizimi i pesë dosjeve të përzgjedhura me short subjektit iu kërkuan shpjegime për dosjet nr. 4 dhe nr. 5.

Dosja 4 – çështja penale nr. *** regj., datë 4.5.2016 regjistrimi, që i përket të dëmtuarve akuzues Xh. B., M. K., i akuzuar A. K., për veprën penale “dëmtime të tjera me dashje”, parashikuar nga neni 90/2 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 16.9.2016. Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 4.5.2016 dhe sipas siglimit të kryetarit të gjykatës datë 5.5.2016 i është caktuar subjektit të rivlerësimit Sokol Pasho. Me vendimin e datës 10.5.2016 (5 ditë nga shorti) për caktimin e seancës për gjykimin e çështjes penale, subjekti ka caktuar seancën e pajtimit në datën 19.5.2016, ora 10:30. Caktimi i seancës respekton afatin e nenit 333/1 të Kodit të Procedurës Penale. Data e seancës i njoftohet prokurorit, të pandehurit, mbrojtësit, të dëmtuarit, palëve private dhe përfaqësuesve të tyre të paktën 10 ditë para datës së caktuar për gjykim. Në rastin konkret është shkelur neni 333/2 i Kodit të Procedurës Penale, pasi seanca është caktuar për 9 ditë. Për këtë gjykim janë zhvilluar shtatë seanca gjyqësore, ndër të cilat dy seancat e para kanë qenë seanca pajtimi.

Në seancën e fundit të datës 16.9.2016 gjykata vendosi deklarinimin fajtor të të pandehurit për veprën penale të parashikuar nga neni 90/2 i Kodit Penal dhe dënimin në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal, me 80 orë punë në interes publik, duke paraqitur të plotë dispozitivin e vendimit. Seanca ka përfunduar në orën 10:47. Procesverbali është i nënshkruar në fund të tij nga sekretarja gjyqësore dhe gjyqtari i çështjes.

Në përfundim të analizimit të këtij rasti, Komisioni ka konstatuar se ndaj vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit është paraqitur ankim dhe Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 6.3.2018, ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 16.9.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pushimin e çështjes për shkak të amnistisë. Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime në lidhje me këtë konstatim.

Në prapësimet e tij subjekti shpjegoi se kjo çështje bën pjesë në të ashtuquajturat “akuza private”, që parashikohen nga neni 59 i Kodit të Procedurës Penale. Ai sqaron se Gjykata e Apelit ka vendosur pushimin e çështjes, pasi në të gjen zbatim amnistia e veprës penale, sipas nenit 6/1 të ligjit nr. 141/2016, “Për dhënie amnistie” dhe në kuptim të përcaktimeve të nenit 428 të Kodit të Procedurës Penale, Gjykata e Apelit nuk ka modus tjetër ligjor për të vendosur në këto raste, përveçse sipas pikës “c” të këtij neni.

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, konstatoi se vendimmarrja e tij për këtë çështje daton më 16.9.2016, ndërsa ligji nr. 141/2016, “Për dhënie amnistie” është

miratuar në datën 22.12.2016. Pra, në kohën e dhënies së vendimit nga subjekti i rivlerësimit ky ligj nuk ishte miratuar ende dhe prishja e vendimit të tij nga Gjykata e Apelit rezulton të jetë kryer në zbatim të këtij ligji të miratuar pas vendimmarrjes së subjektit. Për pasojë, argumentet e subjektit në lidhje me shpjegimet e kërkuara rezultuan bindëse.

Dosja 5 – çështja penale (zëvendësim mase sigurimi) nr. ***, datë 16.5.2016, që i përket kërkuarit M. Gj., me objekt “zëvendësimin e masës së sigurimit arrest në burg me masën e sigurimit detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore, parashikuar nga nenet 260/2 dhe 4 të Kodit të Procedurës Penale”, përfunduar me vendimin e datës 26.5.2016.

Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 16.5.2016 dhe i është caktuar subjektit të rivlerësimit Sokol Pasho. Nga aktet e paraqitura rezulton vendim për caktimin e seancës për gjykimin e kërkesës penale, i datës 17.5.2016 (1 ditë pas shortit), dhe seanca gjyqësore është caktuar në datën 19.5.2016, ora 12:00. Në dosje gjenden edhe aktet e njoftimit të palëve.

Për këtë gjykim janë zhvilluar 4 seanca gjyqësore. Në seancën e datës 26.5.2016 gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, që i përket kërkuarit M. Gj., duke e paraqitur të plotë dispozitivin.

Nga aktet rezulton që vendimi është ankimuar edhe Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 10.6.2016, e cila ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. *** akti, datë 26.5.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në përfundim të analizimit të këtij rasti, Komisioni ka konkluduar se gjykimi nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur gjithsej 9 ditë në intervalin kohor 17.5.2016 – 26.5.2016, jashtë afatit ligjor 5-ditor, bazuar në nenin 260/4 të Kodit të Procedurës Penale. Subjektit iu kërkuan shpjegime në lidhje me këtë konstatim.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit subjekti paraqiti procesverbalet e seancave gjyqësore, nga të cilët evidentohet se afati ligjor 5-ditor për zhvillimin e këtij procesi gjyqësor është tejkaluar për shkak të paraqitjes së provave të reja nga prokurori i çështjes, kërkesës së palës mbrojtëse për t’u njohur me këto prova, si dhe mungesës së prokurorit në seancën e datës 23.5.2016. Subjekti sqaroi se në këto kushte gjendej në pamundësi objektive për të përfunduar gjykimin brenda afatit 5-ditor të përcaktuar në nenin 260/4 të Kodit të Procedurës Penale.

Nga sa më sipër, argumentet e subjektit në lidhje me shpjegimet e kërkuara duken bindëse.

104. Komisioni, pasi vlerësoi prapësimet e subjektit në lidhje me këto dy dosje, çmon se vonesa prej 3 ditësh në gjykimin e çështjes gjyqësore, si dhe ndryshimi i një vendimi nga Gjykata e Apelit për shkak të amnistisë së veprës penale pas analizimit të përgjigjeve të subjektit nuk klasifikohen si mangësi profesionale. Komisioni vlerëson se edhe sikur hipotetakisht këto të klasifikoheshin si mangësi profesionale ato nuk do të ishin të një shkalle për të cilën duhej të aplikoheshin neni 61/4 i ligjit nr. 84/2016.

Të dhëna nga burime arkivore të KLGJ-së lidhur me ankesa, masa disiplinore dhe vlerësime

105. Sipas të dhënave nga databaza e ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për subjektin Sokol Pasho nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin e ish-KLD-së.

106. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për subjektin përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk rezulton që ndaj tij të ketë ardhur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor dhe të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-KLD-ja.

Komisioni ka mbajtur korrespondencë me Prokurorinë e Përgjithshme³⁶, Këshillin e Lartë Gjyqësor³⁷ dhe Ministrinë e Drejtësisë³⁸, të cilat kanë informuar si vijon:

a. Në përgjigjen e tij, Këshilli i Lartë Gjyqësor informon se për subjektin e rivlerësimit, nga data 1.1.2006 deri në datën e kthimit të përgjigjes rezultojnë të regjistruara dy ankesa, si vijon:

- ankesa³⁹ nr. *** prot., datë 7.11.2016, e shtetas D.Xh, e cila rezulton të jetë trajtuar nga Inspektorati i KLD-së dhe pas shqyrtimit paraprak të saj është konstatuar se pretendimet e ngritura janë pretendime që zgjidhen vetëm në bazë të ankimit nga gjykatat më të larta, për këtë arsye ankesa është arkivuar;
- ankesa⁴⁰ nr. *** prot., datë 2.11.2016, e shtetas Z.B, e cila është dorëzuar pranë Zyrës së Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë dhe nuk ndodhet fizikisht pranë KLGJ-së.

Këshilli i Lartë Gjyqësor informon gjithashtu se për subjektin e rivlerësimit nuk rezulton të jenë regjistruar të dhëna për procedime disiplinore.

b. Në përgjigjen e saj, Prokuroria e Përgjithshme ka përcjellë informacionin e dërguar nga prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, si vijon:

- Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka dërguar materialin kallëzues nr. ***. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka dërguar materialin kallëzues nr. ***. Në të dyja rastet prokurori i çështjes ka vendosur mosfillimin e procedimit në lidhje me kallëzimin penal.

c. Në përgjigjen e saj, Ministria e Drejtësisë informon se për subjektin e rivlerësimit janë paraqitur dy ankesa, si vijon:

- ankesa e shtetasit V.Ç – nga dokumentacioni i administruar konstatohet se kjo ankesë është trajtuar nga Ministria e Drejtësisë dhe i është kthyer përgjigje ankuesit duke e orientuar që t’i drejtohet KLD-së;
- ankesa e shtetasit A.B – nga dokumentacioni i administruar konstatohet se kjo ankesë është trajtuar nga Ministria e Drejtësisë dhe i është kthyer përgjigje ankuesit duke e informuar se vendimet e gjykatave kontrollohen vetëm nga sistemi gjyqësor nëpërmjet mjeteve dhe afateve të ankimit dhe se asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e tyre.

³⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 11.11.2020, e Prokurorisë së Përgjithshme.

³⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 13.10.2020, e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

³⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 29.9.2020, e Ministrisë së Drejtësisë.

³⁹ Ankesa e shtetas D.Xh është paraqitur edhe pranë Komisionit dhe është trajtuar në seksionin e denoncimeve.

⁴⁰ Ankesa e shtetas Z.B është paraqitur edhe pranë Komisionit dhe është trajtuar në seksionin e denoncimeve.

107. Denoncime

Për subjektin e rivlerësimit janë administruar 9 denoncime të paraqitura në Komision. Pas analizimit⁴¹ të dokumentacionit të administruar rezulton se në të gjitha denoncimet nuk paraqiten shkaqe apo rrethana në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

Konkluzione për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

108. Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLGJ-ja, denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si më sipër, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit.

109. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional.

110. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se subjekti:

- i. arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- ii. arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- iii. ka një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Sokol Pasho, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore

⁴¹ Për më tepër shihni rezultatet e hetimit administrativ.

dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 16.12.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ
Kryesues

Valbona SANXHAKTARI
Anëtare

Genta Tafa (BUNGO)
Relatore

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha